



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA

**SCC-11-0252**

*Paditësi*

**V (B) J**, nga Gjakova, me vendbanim në Budva, të cilin përmes Projektit për ndihmë juridike, Graçanicë, e përfaqëson avokat, Vasilije Arsić, nga Graçanica, si dhe avokatët Teki Bokshi dhe Korab Bokshi, nga Gjakova

*kundër*

*Të paditurat*

- 1. Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP)**, Rr. “Dritan Hoxha“ nr. 55, Lakrishte, Prishtinë
- 2. NSH “Mulliri” (emërtimi i mëhershëm “Zhitopromet”)**, Gjakovë, e përfaqësuar nga **AKP**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (“DHPGJS”), kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj, gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 9 mars 2022, lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM PËR MOSPARAQITJE**

- 1. Padia hedhet poshtë.**
- 2. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 14 nëntor 2011, paditësi parashtrij padi me propozim për lëshimin e masës së sigurisë pranë DHPGJS.

Paditësi kërkoj që të obligohet AKP që të ndërpres çdo veprim drejtuar shitjes së pronës së paditësit e cila konsiston në paluajtshmërinë- lokalit afarist e cila evidentohet si ngastra kadastrale nr. 5134/18, zona kadastrale Gjakovë – qytet, në sipërfaqe prej 173 metra katrorë, si dhe tokës e cila i takon këtij lokali (prona kontestuese).

Paditësi pohoj se pronësinë mbi pronën kontestuese e ka fituar me Kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë - GJKGJ, Ov. br.581/97 datë 3 tetor 1997.

Sipas paditësit prona kontestuese nuk është e regjistruar në emër të tij pranë zyrës kadastrale në Gjakovë.

Tani, sipas paditësit prona kontestuese është e uzurpuar nga personi i tretë ndaj të cilit, pranë Gjykatës komunale në Gjakovë (tani gjykata themelore) zhvillohet edhe procedura penale, edhe pse sipas tij, nuk disponon me asnjë informatë lidhur me këtë procedurë apo edhe person ndaj të cilit zhvillohet.

Paditësi me padi propozoj lëshimin e masës së sigurisë (tani e tutje: MS) me të cilën do të obligohet e paditura e parë, AKP, që ndaj pronës kontestuese mos të ndërmerr asnjë veprim apo ndonjë ndryshim ligjor apo faktik.

Padisë i janë bashkangjitur:

- Kopja e Kontratës, e lidhur me 16 prill 1996, në mes të NSH “Zhitopromet” dhe paditësit, e vërtetuar pranë GKGJ sipas regjistrimit Ov. br.581/97. Nga kjo kontratë shihet se paditësi ka blerë pronën kontestuese, në shumë prej 512.000 dinarë. (tani e tutje: KONTRATA)
- Kopja e procesverbalit nga ankandi, i mbajtur nga ana e NSH “Zhitopromet”, i datës 12 prill 1996. Nga kjo shihet se nga të gjithë ofertuesit (4 ofertues), çmimi më i lartë është ofruar nga paditësi.
- Kopja e Vendimit, lëshuar nga Ministria e Financave e Republikës së Serbisë – njësia për çështje pronësore juridike, e datës 10 maj 1996, me të cilën palëve kontraktuale, të përshkuar si më lartë, i është lejuar lidhja e kontratës mbi shitblerjen e pronës kontestuese.
- Kopjet e fletëpagesave, sipas kontratës dhe pagesa e tatimit mbi bartjen e paluajtshmërisë.

Me 20 dhjetor 2011, gjykata lëshoj një urdher për paditësin me të cilin i është kërkuar që të deklarohet nëse padia respektivisht MS i drejtohet edhe NSH “Mulliri”, si pronare e pronës kontestuese apo kundër AKP si etnitet i veçantë apo kundër të dyjave.

Me rastin e përkthimit të urdhrin të lartë cekur, në gjuhën Serbe, fjala NSH “Mulliri” gabimisht është përkthyer në NSH “Miftari”. (ky përkthim nuk përkon me urdhrin origjinal të nënshkruar).

Pala paditëse duke ju përmbajtur urdhrin të lartë cekur, me parashtresën e datës 10 shkurt 2012, bën precizimin e padisë ashtu që si palë të paditur shton edhe NSH “Miftari”. (kjo duke vepruar sipas përkthimit të gabuar).

Gjykata lëshoj disa urdhra të natyrës procedurale dhe pala paditëse parashtroj disa urgjenca mbi vendosjen lidhur me MS.

Kolegji i DHPGJS (tani e tutje KS) me Aktvendimin e saj 25 qershor 2012, refuzoj propozimin e paditësit mbi lëshimin e MS si të pabazuar.

Kolegji i Apelit i DHPGJS (tani e tutje: KA), me Aktvendimin e saj AC-I-12-0058 të datës 10 prill 2014, aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, prishi Aktvendimin e KS dhe aprovoj MS si të bazuar ashtu që e paditura është obliguar që pronën kontestuese mos ta shes deri në vendosjen përfundimtare lidhur me padinë.

Bazuar në urdhrat e gjykatës, AKP me 10 korrik 2015 respektivisht me 1 tetor 2015, parashtroj përgjigjen respektivisht kundërpërgjigje.

Paditësi me 15 shtator 2015 parashtroj përgjigjen në përgjigjen e AKP.

Fillimisht me Autorizimin e noterizuar, të parashtruar pranë DHPGJS me 18 nëntor 2015, paditësi autorizoj avokatin Marjan Nrecaj nga Klina, për përfaqësim pranë DHPGJS.

Paditësi me 8 nëntor 2018, parashtroj një kërkesë të dytë mbi lëshimin e MS. Kërkesës i është bashkangjitur autorizimi, me të cilin paditësi tani ka autorizuar avokatin, Vasilije Arsić, nga Graçanica.

Me MS paditësi kërkoj që të ndalohet kryerja e punimeve ndërtimore në pronën kontestuese, me të cilën do të ndryshohej struktura ndërtimore e pronës kontestuese, si dhe të obligohet AKP respektivisht porositësit dhe kryesit e punimeve që të ndërpres të gjitha punimet ndërtimore në pronën kontestuese.

AKP me 16 nëntor 2018, parashtroj përgjigje.

AKP propozoj që propozimi i paditësit të hedhet si i papranueshëm. Sipas AKP prona kontestuese, bazuar në kontratën mbi qiranë e lidhur në mes të NSH "Mulliri" ( autoritetit të likuidimit) dhe Z M shfrytëzohej nga ky person. AKP pohoj se Z M është personi përgjegjës i cili ka filluar punime ndërtimore. AKP tutje pohoj se me qiramarrësin, Z M, ka shkëputur kontratën me 29 mars 2018 dhe se kundër tij është ushtruar kallëzimi penal me 12 prill 2018. AKP pohon se gjithnjë i përmbahet Aktvendimit të KA AC-I-12-0058 të datës 10 prill 2014. Nga të gjitha arsyet propozoj që MS të hedhet poshtë ose të refuzohet si e pabazuar.

AKP përgjigjes i ka bashkangjitur:

- Kopjen e raportit nga vizita në terren, e përpiluar me 21 mars 2018.
- Kopja e njoftimit mbi shkëputjen e kontratës, e datës 29 mars 2018, drejtuar ZM.
- Kopja e kontratës mbi qiranë, e lidhur mes NSH "M" (në likuidim) dhe Z M.
- Kopja e kallëzimit penal kundër Z M, e parashtruar pranë Prokurorisë themelore në Gjakovë, me 12 prill 2018, kallëzim i parashtruar nga AKP.

Përgjigja e AKP i është dorëzuar paditësit.

Me aktvendimin e datës 11 nëntor 2019, MS e propozuar nga paditësi aprovet.

KA i DHPGJS, me aktvendimin e saj AC-I-19-0206, vendimin e lartcekur e prish dhe MS e refuzon.

Seanca gjyqësore, e mbajtur me 22 tetor 2020, është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit të paditësit, avokatit Vasilije Arsic, pasi që sipas tij paditësi në ndërkohë ka autorizuar avokatin edhe Teki Bokshi. Sipas përfaqësuesit të paditësit, avokatit Vasilije Arsic, edhe përkundër tentimeve nuk ka arritur që të kontaktojë me paditësin, lidhur me situatën e krijuar rreth përfaqësimit.

Seanca e dyte me radhë, e mbajtur 18 nëntor 2021, është shtyrë me kërkesë të tani avokatit Teki Bokshi, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

Gjykata ftoj palët për seancën dëgjimore, të caktuar për datën 28 shkurt 2022, me fillim në ora 11.00.

Nga fletëkthesat e pranuar, për seancë, shihej se të gjithë përfaqësuesit e paditësit kanë pranuar ftesat për seancën e datës 28 shkurt 2022

Në seancë ishte prezent përfaqësuesi i të paditurave. E paditura e dytë përfaqësohej nga përfaqësuesi i AKP-së.

Përfaqësuesit e paditësit munguan. Ishin të ftuar në mënyrë të rregullt. Nuk është pranuar ndonjë njoftim pranë DHPGJS me të cilën do të arsyetohej mungesa e përfaqësuesve të paditësve.

Përfaqësuesi i AKP, propozoj kolegjit lëshimin e aktgjykimit për shkak të mosparaqitjes.

### **Arsyvetimi Ligjor**

Sipas nenit, 58.2 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086) – (LDHPGJS) parashihet: “Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjësisht mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale”.

Përfaqësuesit e paditësit janë ftuar në mënyrë të rregullt për seancën dëgjimore të caktuar për datën 28 shkurt 2022. Megjithatë ata nuk janë paraqitur. Pasi që DHPGJS nuk ka pranuar asnjë njoftim me të cilin do të theksonte (si të bazuar) rrethanat të cilat ia kanë pamundësuar prezencën e tyre në seancë si dhe duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të paditurës që të merret Aktgjykim në mungesë, kolegji vlerëson se kushtet ashtu siç janë të parapara në nenin 58.1 dhe 58.2 të Shtojcës janë plotësuar.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv.

### **Shpenzimet**

Paditësi ka paguar taksat gjyqësore me rastin e parashtrimit të padisë.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv.

### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 59.1 dhe 59.2 të LDHPGJS, cilado palë mund të parashtrojë një kërkesë në DHPGJS për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje.

Kërkesa për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje duhet të parashtrohet brenda një muaji nga dita e dorëzimit të aktgjykimit për mosparaqitje të pala gjegjëse.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_

Diellza Hoxha, Gjyqtare

\_\_\_\_\_

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

\_\_\_\_\_